

AKTI THEMELIMIT DHE STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“LOUIS CENTER FASHION 2022” Sh.P.K.

Sot në datën 11/02/2022

Kreu I

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

NENI 1

Forma ligjore dhe emri i shoqerise

- 1.1. “LOUIS CENTER FASHION 2022” Sh.P.K është themeluar bazuar ne ligjin nr.9901, date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”, i ndryshuar, si dhe ne kete Statut qe është njeheresh edhe Akti i themelimit.
- 1.2. “LOUIS CENTER FASHION 2022” Sh.P.K është themeluar dhe funksionon si shoqeri tregtare e formes “me pergjegjesi te kufizuar” (sh.p.k). Nga ketu e meposhte ne kete statut shoqeria “LOUIS CENTER FASHION 2022” do referohet shkurtimisht Shoqeria.
- 1.3. Shoqeria fiton personalitetin juridik si dhe te drejten per te kryer veprime dhe te marre persiper te drejta e detyrime gjate aktivitetit te saj te vazhdueshem, qe nga data e regjistrimit ne regjistrin tregtar.
- 1.4. Shoqeria e realizon aktivitetin e saj, sipas objektit te percaktuar ne kete Statut, bazuar ne legjislacionin shqiptar.

NENI 2

Ortaket e shoqerise

- 2.1. Shoqeria është themeluar, sot, me date 11 Shkurt 2022, nga ortakët:
 - 1) **Z. Esposito Louis, Antoine, Maurice**, atësia Ameglio, lindur në Marseille, France më 27.12.1946, banues në Place Des Maurins 13190 Allauch, France, shtetas francez, madhor, me zotësi juridike dhe zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar me leternjoftim ID nr. 16DT65018, nr.personal 16DT65018, lëshuar më datë 13.07.2016 dhe afat skadimi datë 12.07.2026.
 - 2) **Z. Enzo Louis Jean Esposito**, atësia Jean Jacques, lindur në Marseille, France më 30.05.1998, banues në Place Des Maurins 13190 Allauch, France, shtetas francez, madhor, me zotësi juridike dhe zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar me karte identiteti me ID nr. 150235302957, nr.personal 150235302957, lëshuar më datë 23.02.2015 dhe afat skadimi datë 22.02.2025.

NENI 3

SELIA E SHOQËRISË

Shoqëria do të ketë Seline ne Rruga Kryesore, Autostrada Lezhe- Tirane, km 5, Ndertese ne zonen kadastrale nr.1986, numri i pasurise 136/30.

Shoqëria mund të krijojë Filiale, Zyra Përfaqësimi, në përputhje me legjislacionin shqiptar.

NENI 4

OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

Shoqëria do të ketë si objekt të veprimtarisë së saj:

Import e tregtim me pakice veshmbathje (rroba, kepuce, atlete etj.) te reja e te perdorura. Lavazh automjesh, Bar-Kafe-Restorant. Makina me qera.

NENI 5

KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali themeltar fillestar i shoqërise "LOUIS CENTER FASHION 2022" Sh.P.K., është **100.000 (njqindmijë) lekë**.

Ky kapital është i ndarë në 2 (dy) kuota.

Pjesëmarrja e themeluesve/ortakëve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e tyre te meposhtëm:

1. **Ortaku themelues Enzo Louis Jean Esposito:** zotërues i një (1) kuote me vlerë të përgjithshme 50.000 (pesedhjetemije) leke që përkon me 50 % të kapitalit themeltare.
2. **Ortaku themelues Esposito Louis, Antoine, Maurice:** zotërues i një (1) kuote me vlerë të përgjithshme 50.000 (pesedhjetemije) leke që përkon me 50 % të kapitalit themeltare,.

Kuotat jane nominative dhe nuk mund te perfaqesohen nga letra me vlere.

Çdo kuote perfaqeson te drejten e nje vote.

Kapitali fillestar nuk eshte paguar por duhet te paguhet ne para, brenda 6 muajve nga data themelimit.

NENI 6

MËNYRAT E FITIMIT DHE KALIMI I KUOTAVE

Kuotat e kapitalit dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të përfitohen ose mund të kalojnë nëpërmjet:

- Kontribut në kapitalin e shoqërisë;
- Blerja dhe shitja;
- Trashëgimia;
- Dhurimi;
- Çdo mënyrë tjetër e përcaktuar me ligj.

NENI 7

ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT

Kapitali i shoqërise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë.

Asambleja e Përgjithshme, me shumicën e kualifikuar, mund të rrisë kapitalin themelor të shoqërisë duke rritur kuotat e ortakeve ekzistues në shumën e përcaktuar në vendimin perkates.

Rritja e kapitalit për qëllim të pranimit të anëtarëve të rinj në shoqëri, miratohet nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e votave të ortakeve.

Shoqëria mund të vendosë për të ulur kapitalin themelor te shoqërisë me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të marrë me shumicë votash te kualifikuara.

NENI 8

KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Shoqëria do të kryejë aktivitetet e saj për një periudhë të pacaktuar.

NENI 9

ORGANET E SHOQËRISË

- I. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve
- II. Administratorët

NENI 10

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve të shoqërisë për çështjet e mëposhtme:

- 1) Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë.
- 2) Ndryshimin e statutit.
- 3) Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve.
- 4) Emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar.
- 5) Përcaktimin e shpërblimeve për administratorin, likuiduesin dhe ekspertin kontabël.
- 6) Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë.
- 7) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit.
- 8) Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre.
- 9) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve.
- 10) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- 11) Miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të asamblesë.
- 12) Çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

NENI 11

MBLEDHJA E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME. MËNYRA E THIRRJES

Mbledhja e asamblese mund të jetë e zakonshme ose e jashtëzakonshme.

Asambleja e përgjithshme thirret nga administratoret apo ortakët e percaktuar sipas nenit 84 të ligjit.

Asambleja e Përgjithshme thirret nga administratori të pakten 1 herë në vit, për miratimin e llogarive të shoqërisë, por mbledhje të tjera mund të thirren gjatë vitit për çështje nga me të ndryshmet.

Mbledhja e Asamblese së Përgjithshme thirret nepermjet një shkrese dërguar çdo ortaku me poste të zakonshme ose mesazh elektronik.

Njoftimi duhet të kryhet të pakten 7 dite përpara datës së caktuar për mbledhjen.

Kur Asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikes së mesiperme, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakort, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Kuorumi

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shqoerite Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikes 3 të nenit 88 të këtij ligji.
2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet perseri jo më vonë se 30 dite, me të njetin rend dite.

Marrja e vendimeve

1. Me përjashtim të rasteve kur statute parashikon një shumicë më të lartë, asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votive të ortakëve pjesmarres, siç përcaktohet në pikën 1 të nenit 86 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shqoerite Tregtare", për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

2. Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe ne kete ligj ose ne statut, per çeshtjet e tjera te renditura ne nenin 81 te ketij ligji, asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres.
3. Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe ne kete ligj, vlefshmeria e vendimeve qe percaktojne detyrime shtese mbi ortakët, apo me vendimet qe kufizojne te drejtat e tyre parashikuar ne ligj, ose ne statut, kushtezohet nga miratimi i ortakut perkates.
4. Te gjitha vendimet e asamblese duhet te regjistrohen ne procesverbal.

NENI 12

DREJTA E VOTES

Çdo kuote i jep ortakut te pranishem apo perfaqesuesit te tij te autorizuar te drejten e nje vote.
Asnje ortak nuk ka të drejtë vote në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme nëse nuk ka shlyer tërësisht detyrimet, që kanë të bëjnë me kuotat, që ai disponon.

NENI 13

ADMINISTRATORET

Administratori i shoqerise do te jete:

1. **Z. Aleks Ndoci**, atësia Llesh, lindur në Fshatin Balldre, Lezhe, më, 28.05.1982 dhe banues në Fshatin Balldre Lezhe, shtetas shqiptar, madhor, identifikuar me kartën e identitetit nr.032004483 dhe me nr.personal I20528042C, leshuar me 19.11.2012 dhe date skadence me 18.11.2022.

Administratori emerohet per nje afat pesë (5) vjeçare i cili fillon më datë 11.02.2022. Data e përfundimit të këtij afati është 10.02.2027.

Administratori mund te shkarkohet ne çdo moment nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve, me shumice te thjeshte te votave, me kusht qe ne mbledhje te marrin pjese ortakët me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30 % te kuotave. Statuti apo marreveshje te tjera nuk mund te perjashtohen apo kufizojne kete te drejte.

NENI 14

KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

Administratori ka te drejte dhe detyrohet:

1. Te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tragtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tragtare, te vendosura nga Asambleja e Pergjithshme.
2. Te perfaqesoje shoqerine tregtare.
3. Te kujdeset per perpunimin, administrimin, ruajtjen dhe pergatitjen sakte e te rregullt te dokumentave dhe te librave kontabel te shoqerise.
4. Te beje te mundur pergatitjen nga specialisti i ngarkuar dhe te nenshkruaje bilancin vjetor parashikuar per vitin e ardhshem, per t'u miratuar nga asambleja e pergjithshme, brenda afatit ligjor.
5. Te beje te mundur pergatitjen nga specialist i ngarkuar dhe te nenshkruaje bilancin vjetor te mbyllur, per t'u miratuar nga Asambleja e Pergjithshme, brenda afatit ligjor dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqet keto dokumente perpara Asamblese se Pergjithshme per miratim.
6. Te kryeje regjistrimin e publikimet e detyrueshme te te dhenave te shoqerise.
7. Te raportoje perpara Asamblese se Pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posaçme me rendesi te veçante per veprimtarine e shoqerise tregtare.
8. Te kryeje detyra te tjera, te percaktuara ne ligj, ne statut apo me vendim te asamblese se pergjithshme.

NENI 15

SHPËRNDARJA E FITIMIT VJETOR TË SHOQËRISË

Pjesa e fitimit që i takon secilit ortak nga vlera e fitimit vjetor të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë, vendoset të shpërndahet nga asamblëja e përgjithshme e cila ka kompetencë t'u shpërndajë ortakëve pjesën e fitimit në raport me vlerën e kapitalit të regjistruar, që kuotat e secilit ortak përfaqësojnë.

Po ashtu, Asamblëja e Përgjithshme mund të vendosë që një pjesë e fitimit vjetor të mos t'u shpërndahet ortakëve, por këto shuma të përdoren për zmadhimin e kapitalit fillestar apo për qëllime të tjera, të cilat ajo i konsideron të dobishme për shoqërinë.

NENI 16

PRISHJA E SHOQËRISË, LARGIMI DHE PËRJASHTIMI I ORTAKËVE

Prishja e shoqërisë

Shoqëria priset:

- a) Kur mbaron kohezgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) Me vendim të asamblëse së përgjithshme;
- c) Me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d) Nëse nuk kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr .9723 datë 03.05.2007 "Për QKB";
- e) Me vendim të gjykatës;
- f) Për arsye të tjera, të parashikuara në statut.

Largimi i ortakut

Ortaku mund të largohet nga shoqëria:

1. Nëse ortakët e tjerë ose shoqëria kanë kryer veprime në dem të tij;
2. Nëse është penguar të ushtroje të drejtat e tij;
3. Nëse shoqëria i ka ngarkuar detyrime të paarsyeshme apo për shkaqe të tjera, që e bëjnë të pamundur vazhdimin e ortakërisë.

Perjashtimi i ortakut

Në bazë të një vendimi të zakonshëm, asamblëja e përgjithshme mund t'i kërkojë gjykatës përjashtimin e ortakut, nëse ai nuk ka shlyer kontributin e tij, sipas parashikimeve të statutit, ose nëse ekzistojnë shkaqe të tjera të arsyeshme për këtë përjashtim, të parashikuara në ligj.

NENI 17

LIKUIDIMI I SHOQËRISË

Në rast të likuidimit të shoqërisë, Asamblëja e Përgjithshme emëron një likuidator, i cili administron shoqërinë deri në mbylljen e procesit të likuidimit.

Me vendimin e posaçëm të Asamblëse së Përgjithshme, të marrë me shumicë të kualifikuar, pasi janë shlyer detyrimet ligjore ndaj kreditorëve të shoqërisë, likuidatori shpërndan pjesën e mbetur në raport me vlerën e kapitalit të regjistruar, që kuotat e secilit ortak përfaqësojnë.

NENI 18

FTESA PËR KREDITORËT

Likuiduesit duhet ftojë kreditorët për të depozituar pretendimet e tyre për prishjen e shoqërisë.

Shoqëria e publikon dy herë këtë njoftim, me një interval prej 30 ditësh, në faqen e saj të internetit (web), si dhe në faqen e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit. Në njoftim duhet deklaruar se pretendimet duhet të depozitohen mbrenda 30 ditëve nga data e njoftimit të fundit.

NENI 19

PËRFUNDIMI I LIKUJDIMIT

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon ç'regjistrimin e shoqërisë.

Veprimtaria e likuiduesit nuk mund të kundërshtohet pas çregjistrimit të shoqërisë nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.

NENI 20

MOSMARRËVESHJET

Mosmarrëveshjet zgjidhen me mirëkuptim.

Në rast të kundërt, ortakët themelues do t'i drejtohen Gjykatës Rrethit Gjyqësor Lezhë për zgjidhje.

NENI 21

DISPOZITA E FUNDIT

Për sa nuk është parashikuar në këtë statut, do të bëhet referim në dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Ky statut u hartua në tre (3) kopje autentike, të cilat përbëhen secila nga gjashtë (6) fletë dhe gjashtë (6) faqe.

ORTAKËT

e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar

“LOUIS CENTER FASHION 2022” Sh.P.K.,

1. Z. Enzo Louis Jean Esposito



2. Z. Esposito Louis Antoine Maurice

